



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "OIT Smart & Green" Sh.P.K. të datës 29.07.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 24.07.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Sistemet intelegjente të menaxhimit të ndërtesave dhe zyrave të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-23-2423-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "OIT Smart & Green" Sh.P.K. e datës 29.07.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 24.07.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit "Sistemet intelegjente të menaxhimit të ndërtesave dhe zyrave të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-23-2423-2-1-1.
- II. VËRTETOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 24.07.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. NJOFTOHET** operatori ekonomik "OIT Smart & Green" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "OIT Smart & Green" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 29.07.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 24.07.2023 për anulim të aktivitetit të prokurimit "Sistemet intelegjente të menaxhimit të ndërtesave dhe zyrave të Komunës së Prishtinës" me nr. prokurimi 616-23-2423-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

1. *"Edhe vet AK, e thekson se jemi te pergjegjshem, e ne anen tjeter na dergon leter per ofertuesin e eliminuar,,*
2. *IOT Smart & Green shpk dhe Risamont shpk jane te regjistruara ne ARBK per pune dhe sherbime inxhinierike, cfare edhe eshte e lidhur direkt me natyren e puneve per te cilat ushtrohet aktiviteti i prokurimit. Veprimtaria e sherbimeve te sistemeve te sigurise siq eshte percaktuar ne FDT nuk figuron ne ARBK. Duke qene te specializuar ne fushen e puneve dhe sherbimeve te cilat prokurohen, ne nuk e kemi pare te arsyeshme te kerkojme ndonje ndryshim ne kerkesat e FDT".*

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 6, 7, 56, 59, 69 dhe 72 të LPP.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 04.08.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Lidhur me pikën e parë të pretendimit ankimor, Autoriteti Kontraktues me datë 24.07.2023 ka dërguar te parashtruesi Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar përmes të cilit e ka njoftuar parashtruesin se në përputhje me të gjeturat e komisionit vlerësues i njëjti është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm. Në faqen e dytë paragrafin e dytë të letrës standarde për tenderuesin e eliminuar është bërë një lëshim teknik/gjuhësor ku në vend të fjalës "papërgjegjshëm" është shënuar fjala "përgjegjshëm". Mirëpo përtej këtij gabimi gjuhësor, në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar parashtruesi është njoftuar me të gjitha arsyet e eliminimit të tij si tenderues i papërgjegjshëm. Natyrisht që ky gabim gjuhësor nuk e ndryshon as qëllimin dhe as përmbajtjen e letrës standarde për tenderuesin e eliminuar. Rrjedhimisht kjo pikë e pretendimit ankimor është sa e paqëndrueshme, aq edhe jorelevante dhe e palogjikshme.

Lidhur me pikën e dytë të pretendimit ankimor ku thuhet se *"Veprimtaria e sherbimeve te sistemeve te sigurise siq eshte percaktuar ne FDT nuk figuron ne ARBK"*, duhet cekur se parashtruesi ka pasur mundësi që të parashtroj kërkesë për rishqyrtim ndaj kërkesave të dosjes së tenderit me rastin e publikimit të njoftimit për kontratë. Megjithatë parashtruesi asnjëherë nuk ka kontestuar këtë kërkesë të dosjes së tenderit që nënkupton se është pajtuar në tërësi me kërkesat e dosjes së tenderit. Ky fakt nuk është kontestues pasi që edhe vet parashtruesi në kërkesën e tij për rishqyrtim e pranon që *"ne nuk e kemi pare te arsyeshme te kerkojme ndonje ndryshim ne kerkesat e FDT"*. Mirëpo edhe po të ishte i qëndrueshëm kjo pikë e pretendimit ankimor ku thuhet se veprimtaria me shërbimet e sistemeve të sigurisë nuk figurojnë në ARBK, në fakt kjo do të përbënte një argument shtesë për të anuluar aktivitetin e prokurimit. Pra vet pika e pretendimit ankimor e formuluar në mënyrën si e ka bërë parashtruesi është argument i cili e fuqizon vendimin e Autoritetit Kontraktues për të anuluar aktivitetin e prokurimit dhe jo për të miratuar si të bazuar kërkesën për rishqyrtim të parashtruesit. Me fjalë të tjera kjo pikë e pretendimit ankimor është prima facie e paqëndrueshme - pra qysh në shikim të parë.

Sidoqoftë në dosjen e tenderit në kuadër të kërkesave mbi përshtatshmërinë profesionale (7.1 & 7.2) është evidentuar kërkesa dhe dëshmia dokumentare si në vijim:

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale: 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit për ushtrimin e veprimtarisë së sistemeve të sigurisë - numri unik Identifikues te regjistrimit.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1.Kopja e Certifikatës se biznesit
--	-----------	--	--

Në ofertën me të cilën ka tenderuar parashtruesi ndër të tjera është dorëzuar edhe certifikata e biznesit me nr. serik 10108609 ku si aktivitet kryesor janë evidentuar “Instalimet elektrike” sipas kodit 4321 ndërsa si aktivitete shtesë janë deklaruar “ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore” me kod 4120 pastaj “tregtia me shumicë e drurit, materialeve të ndërtimit dhe pajisjeve hidrosanitare” me kod 4673, “Aktivitetet e inxhinierisë dhe këshillimit teknik” me kod 7112, “testimi teknik dhe analizat” me kod 7120, “aktivitetet e ndërmjetësimit të specializuar për shitjen e produkteve” me kod 4618 si dhe “tregtia me shumicë e pajisjeve elektroshtëpiake” me kod 4643.

Nga analizimi i kodeve të veprimtarisë të cituara më sipër nga certifikata e biznesit të parashtruesit është gjetur se asnjë nga këto veprimtari nuk është e njëjtë apo e ngjashme me veprimtarinë e sistemeve të sigurisë sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Vlen të shtohet që edhe vet parashtruesi e pranon që veprimtaria e kërkuar me dosjen e tenderit nuk evidentohet me certifikatën e tij të biznesit. Në këtë mënyrë është gjetur se edhe kjo pikë e pretendimit të tij ankimor është e pabazuar në tërësi.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.


Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 04.08.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.